

## USAID dhe Revista National Geographic promovojnë Shqipërinë dhe fqinjët ballkanikë

**TIRANË, 21 KORRIK 2010** Falë mbështetjes së USAID-it, Shqipëria është një nga gjashtë vendet ballkanike të prezantuara në suplementin e muajit Qershor të revistës National Geographic Traveler Magazine. Suplementi me titull **Ballkani Perëndimor Vendi i Zbulimeve** demonstroi thesaret natyrore, historike dhe kulturore të rajonit. Suplementi iu shpërnda operatorëve turistikë dhe bizneseve në një pritje të zhvilluar sot në Tiranë. Fjalimet e rastit u mbajtën prej Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve z. Ferdinand Xhaferaj, Drejtorit të Misionit të USAID-it në Shqipëri, z. Xhozef C. Uilliam (Joseph C. Williams), si dhe prej Zëvendës Ministres së Punëve të Jashtme, znj. Edith Harxhi.

E izoluar nga pjesa tjetër e botës për 50 vite, Shqipëria mbetet ende gjerësisht e panjohur jashtë Evropës dhe ka ndeshur vështirësi në kapërcimin e stereotipizimeve negative të lidhura me varfërinë, korrupsionin dhe krimin, si dhe ndryshe nga fqinjët e saj ballkanikë, Shqipërisë i është dashur të trajtojë disavantazhe domethënëse, të tilla si infrastruktura e dobët, zhvillimi i paplanifikuar urban dhe mungesa e investimeve, tha z. Uilliams gjatë aktivitetit. Më shumë duhet dhe mund të bëhet për të ruajtur trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, për të ruajtur burimet natyrore, si dhe për të mbrojtur monumente të çmuara arkeologjike dhe historike.

USAID-i po ndihmon në nivel rajoni dhe në nivel vendi për promovimin e imazhit të Shqipërisë si një vendmbërritje tërheqëse dhe unike turistike. Muajin e shkuar, revista National Geographic Traveler Magazine botoi një suplement prej 47 faqesh mbi Ballkanin Perëndimor, i cili përmbante fotografi dhe artikuj mbi historinë, kuzhinën e kulturën e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Ky suplement shoqëroi numrin e botimit në anglisht të revistës National Geographic Traveler Magazine të muajit qershor 2010 duke iu shpërndarë mbi 220,000 të abonuarve në Mbretërinë e Bashkuar, në Hollandë dhe në Gjermani.

Kopje të këtij botimi do të jenë të disponueshme përmes Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Shoqatës së Turizmit Shqiptar dhe Projektit të USAID-it Rritje Albania të gatshme për t'u shpërndarë operatorëve të huaj turistikë dhe ambasadave e konsullatave shqiptare për të promovuar paketa turistike për Shqipërinë dhe rajonin.

Turizmi është pranuar si një sektor i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë, me mundësinë për të përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat e thella të vendit e të prekura prej varfërisë.

**Mbi Rritje Albania** Rritje Albania, projekti i USAID-it për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Konkurruese, mbështet rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe me bazë të gjerë në Shqipëri duke zgjeruar tregtinë dhe investimet, duke rritur prodhimtarinë e ndërmarrjeve, si dhe duke përmirësuar fuqinë punëtore shqiptare. Projekti ndihmon ndërmarrjet jo bujqësore të jenë konkurruese më të forta në treg, të rrisin shitjet dhe të krijojnë vende të reja pune. Për më tepër informacion mbi nismat e USAID Shqipërisë në fushën e turizmit lutemi të vizitoni faqen e internetit: [www.rritjealbania.com](http://www.rritjealbania.com) ose të kontaktoni Rritje Albania përmes adresës së postës elektronike: [info@rritjealbania.com](mailto:info@rritjealbania.com).